

DISPOZITA T PANDERSHME N KONTRATAT KONSUMATORË



Организација на потрошувачите
на Македонија




Министерство за Економија



**Организација на потрошувачите
на Република Македонија**

Водњанска, 66, П. Фах 150, Скопје
Тел. 02 3179 592

e-mail: sovetuvanja@opm.org.mk
www.opm.org.mk



Këto janë disa rregulla shumë të rëndësishme gjatë lidhjes së kontratave edhe në raste kur kontrata përmban dispozita të pandershme:

- Çdo herë me kujdes ti lexoni dispozitat e kontratës që kanë të bëjnë me të drejtat dhe obligimet tuaja. Kontrata duhet të jetë e shkruar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.
- Komunikoni në formë të shkruar. Në formë të shkruar kërkoni shpjegime plotësuese për çdo paqartësi të cilën e keni ndaj kontratës.
- Lajmërojeni inspektoratin shtetëror të tregut. Kërkoni ndihmë nga organizata e konsumatorëve, kërkoni ndihmë nga këshilli i konsumatorëve në qytetin/komunën tuaj, nëse keni ndjenjë se ndonjë tregtarë i caktuar e shkelë të drejtën tuaj me dispozita të pandershme të kontratës. Paraqiteni rastin personal deri tek organet kompetente.
- Dispozitat e paqarta dhe kontestuese të kontratës të cilat janë hartuar nga tregtari duhet të interpretohen në favorin tuaj.
- Nëse ekzistojnë dispozita të pandershme në kontratën, informoheni për atë tregtarin dhe kërkoni që ai ti largoj nga kontrata e lidhur. Nëse nuk e realizon atë, ju mund të kërkoni që dispozitat e pandershme të anulohen nga gjykata.
- Nëse dispozitat e pandershme kanë të bëjnë me elemente të rëndësishme të kontratës dhe kontrata nuk mund të mbijetoj pa atë dispozitë atëherë kontrata në tërësi është e pavlefshme, gjegjësisht kontrata konsiderohet sikur asnjëherë mos të ketë ekzistuar.

Ju jeni grupi më i fuqishëm dhe më masiv! Të gjithë jemi konsumator!

Konsumatorë, mbani në mend, ju duhet të keni trajtim korrekt dhe transparent gjatë lidhjes së çdo lloji të kontratave, si për kontratat për shitje ashtu edhe për kontratat për shërbime.

- As një herë mos hezitoni ta shprehni mendimin tuaj.
- Për parat që me mund i keni fituar duhet çdo herë të kërkoni dhe të pranoni mallrat dhe shërbimet më të mira.
- Tregoni tregtarit çfarë mendoni ju se i mungon mallit ose shërbimit të cilat u ofrohet. Pyesni dhe kërkoni qartësim për çdo gjë të paqartë.
- Tentoni që kontestin me tregtarin ta zgjidhni, por nëse ai nuk është i gatshëm për zgjidhje të qetë, kërkoni zgjidhje gjyqësore.
- Klauzolat e pandershme të kontratave mund të jenë në formë gojore dhe me shkrim.
- Para se të firmosini, lexoni mirë çfarë përmban kontrata dhe mos e firmosni nëse nuk kuptoni ndonjë dispozitë të kontratës.

Terminologjia juridike është shumë specifike. Do të përpiqemi që t'ju njoftojmë me termet më të rëndësishme.

Fjalor modest për termet kryesore:

Konsumator është çdo person fizik i cili blen ndonjë prodhim ose shfrytëzon ndonjë shërbim për konsumim të tij personal në hapësirat afariste të tregtarit, jashtë hapësirave afariste si dhe me kontrata të lidhura nga larg për qëllime të cilat nuk janë pjesë të veprimtarisë së tij afariste, tregtare, zejtarie ose profesionale; Kontrata për konsumatorë paraqet kontratë për shitje dhe kontratë për shërbim në të cilën njëra palë është çdo herë konsumatori ndërsa pala tjetër është tregtari;

Kushtet e përgjithshme të kontratës janë klauzola paraprakisht të përcaktuara nga njëra palë. Kushtet e përgjithshme mund të përfshihen në kontratën e hartuar ose mund të jenë edhe jashtë kontratës. Kushtet e përgjithshme, vetvetiu nuk janë të zbatueshme në raport të palës kontraktuese e cila nuk ka marrë pjesë në përcaktimin e tyre. Që të mundësohet zbatueshmëria e tyre, duhet të njihen edhe nga pala tjetër, ose është dashur të njihen, në momentin e lidhjes së kontratës. Kjo praktikisht do të thotë se pala tjetër është pajtuar me kushtet e përgjithshme, gjegjësisht i ka pranuar. Kushtet e përgjithshme paraqesin klauzola abstrakte dhe sikur edhe normat juridike, nuk i referohen ndonjë kontrate konkrete por bëhen të zbatueshme në një numër të marrëdhënieve të veçanta kontraktuale të të njëjtit lloj. Ata janë gjithashtu edhe të njëjlojshme dhe të pandryshueshme në kontratat konkrete, në kuptimin se, siç janë të dhëna, bëhen pjesë të raporteve që dalin nga kontratat madje edhe i plotësojnë, siç është rasti tek normat plotësuese, gjegjësisht atyre imperative. Shpesh tregtarët dhe ofruesit të shërbimeve në kontratat e tyre thirren në kushtet e përgjithshme për punë; Kontratë e formuluar paraqet term i përbashkët për kontratat tipike dhe kontratat e adezionit. Midis kushteve të përgjithshme dhe kontratave të formuluar ekzistojnë dallime terminologjike dhe substanciale. Kushtet e përgjithshme çdo herë plotësojnë ndonjë kontratë ekzistuese midis palëve. Ndërsa kontratat e formuluar e përfaqësojnë tërësinë e raportit që rezulton midis palëve nga kontrata, me zbatim plotësues të burimeve tjera juridike (norma imperative, praktika e përcaktuar, zakonet, normat dispozitive, etj). Kontratë e formuluar paraqet tekstin e hartuar me shkrim nga tregtari ose nga ofruesi i shërbimeve të cilin ju si konsumator duhet ta firmosni dhe në atë mënyrë ta shprehni pajtimin tuaj;

Kontrata tipike paraqet formë paraprakisht e hartuar të kontratës së formuluar me të cilën mund të negocohen elementet e rëndësishme të kontratës ose për klauzola të caktuara të kontratës;

Kontrata e adezionit si kontrata të formuluar nuk japin hapësirë për negociatë, ata janë të llojit mere ose lere. Numri më i madhe i kontratave janë të këtij lloji;

Dispozitë e kontratës paraqet një dispozitë, një nen i kontratës, një obligim i kontratës për njërën palë ose një e drejtë për palën tjetër. Kontrata shpesh mund të mbijetoj edhe pa ndonjë dispozitë nëse ajo dispozitë nuk paraqet element i rëndësishëm i kontratës.

Dispozitë e pandershme dhe e padrejtë e kontratës paraqet dispozitë e kontratës për të cilën nuk është negociuar në veçanti dhe në kundërshtim të parimit të përgjegjësisë dhe ndershmërisë, krijon një disproporcion midis të drejtave dhe obligimeve të palëve në dëm të konsumatorit.

Sot një pjesë më të madhe të kontratave të cilat i lidhim me konsumatorët janë të llojit mere ose lere. Kontrata me vlerë të vogël, siç janë kontratat për parkim të makinave për një orë në parking publik, vlera e të cilës mund të jetë 20 denarë, si edhe kontratat për blerjen e makinave, vlera e të cilës mund të jetë 50.000 euro lidhen me anë të kushte paraprakisht të përcaktuara kontraktuale ose me anë të kushteve të përgjithshme për punë, për të cilat konsumatori mund të negocioj. Konsumatorët për çdo ditë lidhin një numër të madh të kontratave me përmbajtje paraprakisht të standardizuar dhe të formuluar. Kontratat e tilla janë kontratat për blerjen e telefonave celular, kontratat për shërbime të operatorëve mobil, kontrata për blerjen e biletave për aeroplan, kontrata për pako të aranzhmanit turistik, kontratat për lidhje me rrjetin ujësjellës, për pastrimin e mbeturinave, për lidhje rrjetin për furnizim me energji elektrike dhe shumë të tjerë.

Dhe përderisa kontratat realizohen ose nuk ndodhin gjëra që mund të sjellin pasoja negative pronës tonë ose të drejtave tona, ne nuk jemi të vetëdijshëm për çfarë kontratë jemi lidhur. Megjithatë, nëse është thyer xhami i

makinës së parkuar në parking publik dhe janë marrë gjërat që i kemi lënë brenda, kuptojmë se kemi lidhur kontratë për qira të hapësirës ku është parkuar makina, e jo edhe kontratë për depozitë ose kujdes të makinës. Kur do të na e humbin bagazhin gjatë fluturimit, atëherë bëhemi të vetëdijshëm se çka do që kemi pasur në bagazhin tonë kompensohet me vlerë paraprakisht të caktuar. Atëherë kur dëshirojmë të zëvendësojmë ndonjë pajisje të cilën e kemi blerë e ajo nuk funksionon, kuptojmë se jo çdo defekt pranohet nga garancia. Të tilla janë të gjithë ato rregullat të ndryshme lidhur me garancitë për telefonat celular. Anulim i pakove turistike me arsye të arsyetueshme nga konsumatori, gjithashtu do të rezultojë me kompensim të cilin duhet ta mbulojë konsumatorit, ndërsa organizatori në ofertën mund të jetë i liruar nga përgjegjësia për anulimin e aranzhmanit nga ana e tij. Kontratat bankare për kredi ose kredit kartele gjithashtu mund të fshehin shumë kurthe për konsumatorin, shpenzime të fshehura, mundësi për ndryshimin e kësteve, vështirësi për shkëputjen e kontratës. Sigurimi i pronës dhe i jetës ndonjëherë janë të vështira për ti kuptuar pasi që ekzistojnë dallime për atë se çka është përfshirë, e çfarë nuk është përfshirë me sigurimin, vallë nëse një herë e shfrytëzoni në tërësi kasko sigurimin e makinës, do të thotë se për aksidentin e dytë ju do të participoni për dëmin e shkaktuar? Shumë herë, secili nga ne ka hyrë në ndonjë situatë, si pasojë të kontratës të cilën e ka nënshkruar, për të cilën nuk ka qenë i vetëdijshëm në momentin e lidhjes së kontratës. Andaj, dëshirojmë të ju prezantojmë disa rregulla, të cilat mund të ju ndihmojnë në njohjen e klauzolave të pandershme të kontratave dhe procedurat të cilat mund ti ndërmerrni nëse keni nënshkruar kontratë e cila i përmban klauzola të tilla.

Test në tre hapa: Si ti identifikoni dispozitë të pandershme?

Në vendet e Bashkimit Evropian, por, edhe në vendin tonë, parashihet test në tre hapa me të cilin do të vlerësohet nëse dispozita e marrëveshjes mund të llogaritet si e pavlefshme ose e padrejtë. Secila dispozitë e tillë duhet të e kalojë testin e radhës ose të përgjigjet në këto tre pyetje:

1. A janë realizuar negociata për dispozitat në mënyrë të veçantë? A është vënë ajo dispozitë në përputhje me vullnetin e palëve (konsumatorit dhe tregtarit) ose ajo është bërë paraprakisht dhe vetëm i ofrohet konsumatorit në mënyrë merre ose lere?
2. A e vendos dispozita njëri nga palët në gjendje të pafavorshme? (që të jetë dispozita e pavlefshme duhet të ekzistoj një ekuilibër në përfitime reciproke mes dy palëve);
1.A është dispozita në kundërshtim me parimin e ndërgjegjes dhe ndershmërisë?

Si i ka definuar legjislatori ynë klauzolat e pavlefshëm?

Fillimisht ligjdhënësi ka përcaktuar idenë e dispozitave të pavlefshme ose çfarë konsiderohet si dispozitë e pavlefshme në kontratën e konsumatorit.

Ligjdhënësi qartëson se: „një dispozitë e veçantë kontraktuale do të llogaritet se nuk është negociuar individualisht nëse ajo dispozitë ka qenë paraprakisht e përgatitur nga ana e tregtarit, dhe konsumatori nuk ka pasur ndikim në përmbajtjen e saj, veçanërisht nëse bëhet fjalë për dispozita të cilat kanë qenë paraprakisht të formuluar në kontratat standarde të tregtarit. Nëse tregtari pretendon se një dispozitë e tillë kontraktuale, e vënë në kontratën standarde, janë dakorduar individualisht, atëherë e ka për detyrim ta tregojë atë.

Duhet të dimë se këto norma të ligjit për dispozita të pavlefshme, nuk zbatohen përderisa dispozitat e marrëveshjes janë të përfshira në dispozita të një natyre të detyruar, ose dispozitat dhe parimet janë të vendosura nga Konventat dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Maqedonisë. Ligjdhënësi ka konstatuar se para vlerësimit nëse dispozita e përkohshme e konsumatorit është e vlefshme apo jo, do të merret parasysh cilësia e produktit ose shërbimi që është objekt i kontratës, të gjithë rrethanat para ose pas lidhjes së kontratës, dispozitat tjera kontraktuese, si dhe ndonjë kontratë tjetër, në lidhje me kontratën që vlerësohet, paraqet kontratë kryesore.

Ligdhënësi ka përpiluar një listë me klauzola të pandershme:

- Si e pavlefshme llogaritet dispozitat në kontratën konsumatore dhe kushtet apo kombinimet e dispozitave dhe kushteve që kanë për qëllim që para lidhjes së marrëveshjes të përcaktojnë obligim përfundimtarë për konsumatorin, ndërsa për tregtarin janë paraparë kushte që realizimi i tyre varet prej vullnetit të konsumatorit.
- Si e pavlefshme llogaritet dispozita në kontratën e konsumatorit me të cilën tregtarit i lejohet ta ndryshojë çmimin në varësi nga elementet, që ekskluzivisht janë të varura nga vullneti i tregtarit.
 - Nuk do të llogaritet si dispozitë e pavlefshme, dispozita e cila tregtarit i lejohet të ndryshojë çmimin për:
 - ◆ shkallën luhatëse për korigjim të çmimit, masa që dispozita është e ligjshme, ndërsa mënyra për rregullimin e çmimit është përcaktuar shprehimisht në marrëveshje;
 - ◆ dispozitën sipas së cilës tregtari i shërbimeve financiare lejon të drejtën për ta ndryshuar tarifën e shërbimeve të tilla, me kusht që të ekzistojë obligim për tregtarin ta njoftojë konsumatorin për afatin e përcaktuar, ndërsa konsumatori të ketë të drejtë menjëherë ta tërheq kontratën;
 - ◆ dispozitën sipas së cilës tregtari i shërbimeve financiare e rezervon për vete të drejtën për ta ndryshuar normën e interesit pa e njoftuar konsumatorin, nëse ekziston bazë për atë, i obliguar tregtari ta njoftojë konsumatorin sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe me të drejtë konsumatori menjëherë ta tërheq kontratën.
- Si e pavlefshme llogaritet dispozita e kontratës së konsumatorit, më të cilën tregtari me vete e rezervon të drejtën e njëanshme që ti ndryshojë karakteristikat e produktit që duhet të porositet ose shërbimi i cili duhet të kryhet, nëse karakteristikat e tilla janë prej natyrës thelbësore për marrëveshjen e konsumatorit ose për atë se konsumatori ka planifikuar për atë produkt apo shërbim, përderisa konsumatori është pajtuar me atë ose kur nuk ka ekzistuar asnjë specifikim, një pretendim i tillë mundë të parashikohet në mënyrë të arsyeshme;
- Si e pavlefshme llogaritet dispozita e kontratës së konsumatorit, më të cilën tregtari fuqizohet njëanshëm për ta përcaktuar ose ndryshuar kohën e dorëzimit apo kryerjes së shërbimit;
- Si e pavlefshme llogaritet dispozita e kontratës së konsumatorit, më të cilën tregtarit i jepet e drejtë që personalisht ta përcaktojë se produkti i porositur ose shërbimi i bërë është në pajtueshmëri me kontratën, ose tregtari e posedon të drejtën ekskluzive për t'i interpretuar dispozitat e marrëveshjes që nuk janë të specifikuara;
- Si e pavlefshme llogaritet dispozita e kontratës e cila i ndalon konsumatorit ta tërheq marrëveshjen nëse tregtari nuk i përmbush obligimet e tij;
- Si e pavlefshme llogaritet dispozita e kontratës së konsumatorit, e cila e kufizon të drejtën e konsumatorit për ta tërhequr kontratën, kur në pajtueshmëri me obligimin për garanci, tregtari nuk e respekton obligimin tij për heqjen e mangësive ose nuk i tërheq mangësitë brenda afatit të caktuar;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit e cila e detyron konsumatorin ti kryej detyrimet e tij sipas kontratës edhe përkundër asaj që tregtari nuk i ka përfunduar ose është vonuar në ushtrimin e detyrave të tij;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit e cila e fuqizon njëanshëm tregtarin për ta tërhequr ose për ta ndryshuar marrëveshjen, pa kompensim për konsumatorin, përveçse në raste të nevojës së skajshme.
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën në rast të forcës së madhe konsumatori detyrohet ta tërheq kontratën vetëm me parapagim të dëmeve;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën tregtari, agjentet ose punëtorët lirohen nga përgjegjësia për dëmet në rast të akuzës ose në rast të mos kryerjes të detyrimit, gjë që paraqet elementin thelbësorë i kontratës;

- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën tregtari lirohet nga përgjegjësia për të metat juridike dhe materialet e fshehura;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën i ndalohet konsumatorit për ta bërë bilancin e detyrimeve të tij me ato të tregtarit, kur për to janë përmbushur kërkesat ligjore;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën përcaktohet një periudhë që konsumatori duhet ta njoftojë tregtarin në lidhje me mangësitë e produktit apo shërbimeve;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën paraprakisht përcaktohet shuma e shpenzimit të dëmit, që konsumatori duhet ta paguaj në rast të mos përmbushjes së ndonjë detyrimi të tij, pa pasur nevojë pas saj të përcaktojë një sasi të saktë të kompensimit në rast të mos përmbushjes së detyrimit nga ana e tregtarit;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën vërtetohet detyrimi për ta zbatuar marrëveshjen e tregtarit në kohë caktuar, pa caktuar afat të arsyeshëm për ndërprerje apo tërheqje të marrëveshjes;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën shtyhet vlefshmëria e marrëveshjes në një kohë të caktuar ose nëse konsumatori nuk e ka tërhequr kontratën për ndonjë afat të caktuar, se automatikisht shtyhet vlefshmëria e kontratës në ndonjë kohë të caktuar në kundërshtim me njoftimin e konsumatorit, nëse konsumatorit i është dhënë afat më të shkurtë për njoftim në lidhje me vazhdimin e kontratës nga koha e caktuar për skadimin e kontratës;
- Si të pandershme llogariten dispozitat e kontratës me të cilat në rast të mosmarrëveshjes; kufizimi i provave që mund të shfrytëzohet nga konsumatori;- i ofrojnë konsumatorit që të tërhiqet nga mjetet e tij juridike kundër tregtarit dhe - i lejojnë tregtarit përzgjedhje për një kohë të caktuar për venddodhjen ose vendbanimin që është shprehur në kontratë, kërkesën e tij ta shpallë në një vend që është i ndryshëm nga rregullat e aplikueshme të juridiksionit;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën paraprakisht në mënyrë abstrakte përcaktohet shuma e kompensimit të dëmit, e cila mund të kërkohet në rast të vonesës ose vonesë në kryerjen e detyrimeve të konsumatorit që padyshim e tejkalon fushën e dëmit që tregtari ndoshta mundë ta pësojë për shkak të dështimit ose vonesës së konsumatorit;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratat e tregtarit me të cilën përjashtohet apo kufizohet përgjegjësia e tregtarit në rast të vdekjes, lëndimeve trupore të konsumatorit. Kufizimi i shumës së kompensimit në këto raste që duhet tregtari të paguaj konsumatorin ose ndonjë prej anëtarëve të familjes nuk do të llogaritet si e pandershme në qoftë se është e lidhur sasia e tarifës më të lartë të konsumatorit që konsumatori do ta marrë nga kompania e sigurimit në qoftë se ka qenë i siguruar;
- Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e tregtarit me të cilën tregtarit në rast të mos përmbushjes ose tërheqje të marrëveshjes i lejohet ti mbajë shumat e paguara nga konsumatori me përfundimin e kontratës, në të njëjtën kohë pa u përcaktuar e drejta e konsumatorit për të paguar shumë ekuivalente nga tregtari në rast të tërheqjes ose mos përmbushjes së kontratës. Si e pandershme llogaritet dispozita në kontratën e konsumatorit kur konsumatori është ai që e ka tërhequr kontratën;
- Si të pandershme llogariten dispozitat e kontratave konsumatorë me të cilat kufizohet përgjegjësia i tregtarit që ti respektoj obligimet të cilat janë ndërmarrë nga përfaqësuesit e tij ose imponon ndonjë formalitet për obligimet e tregtarit të ndërmarra përmes përfaqësuesit;
- Si e pandershme llogaritet dispozita e kontratës konsumatorë me të cilën në mënyrë të padrejtë përjashtohen ose kufizohen të drejtat ligjore dhe obligimet të konsumatorit në raport me tregtarin ose në raport të personit të tretë në rast të mosrealizimit të plotë ose të pjesshëm i obligimeve të kontratës nga ana e tregtarit;

- Si e pandershme llogaritet dispozita e kontratës konsumatorë me të cilën tregtarit i jepet e drejta pa pëlqimin e konsumatorit t'ja delegoj realizimin e kontratës personave të tretë, nëse ekziston dyshim i bazuar se delegimi i tillë do të sjellë deri në ulje të garancisë të cilën e ka konsumatori;
- Si e pandershme llogaritet dispozita e kontratës konsumatorë me të cilën nuk lejohet që të vlerësohet se a janë të ndershme dispozitat e kontratës dhe çmimi, nëse dispozita janë të qarta, lehtë për ti lexuar dhe të dukshme.

A janë të obligueshme dispozitat e pandershme të kontratës?

Dispozitat e pandershme të kontratave nuk obligojnë. Dispozita e padrejtë e kontratës është e pavlefshme. Pavlefshmëria e dispozitave të caktuara të kontratës nuk e bën edhe vet kontratën e pavlefshme, nëse i njëjti mund të mbijetoj edhe pa dispozitën e pavlefshme.

Kush mund të turet në pavlefshmërinë e dispozitave të pandershme të kontratës?

Secili që ka interes të arsyeshëm për mbrojtjen e konsumatorëve, si edhe shoqatat për mbrojtjen e konsumatorëve, mund të kërkoj nga gjykata ta shpallë si të pavlefshme dispozitën e kontratës, nëse vërtetohet se dispozita sipas dispozitave ligjore është e pandershme.

Procedurat për shpallje e dispozitave si të pavlefshme mund të ngritën ndaj ndonjë tregtari të caktuar, ndaj më shumë tregtarëve pjesë të veprimtarisë së njëjtë, si dhe ndaj shoqatat e atyre tregtarëve të cilat përdorin dispozita të pandershme në kontratat.

Padia me të cilën kërkohet ndonjë dispozitë e caktuar e kontratës të shpallet si e pandershme dhe e pavlefshme është deklarative. Me vendim gjyqësor dispozita e pandershme shpallet si e pavlefshme, ajo nuk prodhon akt juridik ndërmjet palëve. Nëse konsumatori ka dhënë diçka në bazë të dispozitave të pavlefshme të kontratës, tregtari ka obligim ta kthej atë.

Edhe disa shembuj për dispozita të pandershme të kontratave: konsumatorët duhet të kenë kujdesë gjatë lidhjes së kontratave (p.sh. për kredi kartele ose për kredi) mos të pranojnë dispozita të kontratave të cilat krahas interesit penal për vonesë të realizimit të obligimeve, duhet të paguajnë edhe kompensim për dërgesën e vërejtjes për vonesë, ose interes penal i përcaktuar me kontratën të kumulohet me dispozitë të pandershme dhe penale për vonesat të cilat sipas ligjeve tona në fuqi mund të parashihen vetëm për obligime jo-materiale. Konsumatorë! Shpesh nga dëshira që të lidhni kontratë të caktuar për ndonjë mall ose shërbim, përballeni me kontrata të gjata ose kontrata u drejtohet kushteve të përgjithshme të kontratës, nuk i njihni në tërësi të drejtat dhe obligimet tuaja dhe firmosni ose e shtypni pullën "pajtohem", me çka lidhni kontratë pa ditur saktë për çfarë jeni pajtuar. Mos lejoni që tregtarët të përfitojnë mbi krahun tuaj me dispozita të pandershme të kontratave!